

Prishtinë: 03 Maj 2007
Kodi i ZRRE-së: D_46_2007

Duke marrë parasysh:

1. Nenin 15 dhe 34/a të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe
2. Nenin 4 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në seancën e mbajtur më 3 Maj 2007 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

REFUZOHET aplikacionit i MC INVEST CONSULTING AD për Licencë për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike.

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) me datë 09.10.2006 ka pranuar me postë të rregullt aplikacionin për licencë Furnizim/Tregti me Energji Elektrike të dërguar nga kompania MC INVEST CONSULTING AD.
2. Gjatë vlerësimit të parë të aplikacionit si dhe dëshmive të dërguara është vërtetuar mungesa e këtyre dëshmive:
 - Çertifikatën që Aplikuesi është i rregullt në pagimin e taksave – lëshuar nga agjencia e taksave- pika 2 e aplikacionit;
 - Çertifikatën që Aplikuesi nuk është subjekt i ndonjë procedure për paaftësi paguese apo likuidim – lëshuar nga institucioni kompetente- pika 3 e aplikacionit;
 - Deklaratën e Aplikuesit mbi të ardhurat vjetore për (3) tre vjetët e fundit. Nëse deklarata financiare vjetore e Aplikuesit i është nënshtruar revizionit të pavarur financiar, atëherë ai duhet të paraqesë edhe raportin e auditorit ndaras nga deklaratës financiare – pika 4 e aplikacionit;
 - Kopjen e regjistrimit të pjesëmarrjes aksionare me përqindje ose të barabartë të ndonjë aksionari apo partneriteti me Aplikuesin, përfshirë kopjet e dispozitave të shoqatës, vendimet e Gjykatës ose librit të aksionarëve- pika 7 e aplikacionit;
 - Dëshmi e pagesës së taksës së aplikacionit – pika 11;
 - Të dhëna mbi burimet materiale në pronësi, përfshirë të dhënat mbi rrjetet e ndërtuara, posedimin e softuerit për kryerjen e aktiviteteve – pika 1 të kushteve specifike në aplikacionit.
3. Në kontaktet e drejtpërdrejta telefonike me përfaqësues të Kompanisë në fjalë, si dhe me e-mail të datës 24.10.2006 janë kërkuar dëshmitë që mungojnë.

4. Me datën 27.03.2007 edhe njëherë kemi kërkuar që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh të dërgohen dëshmitë e kërkuara.
5. Pasi palës është lejuar afati i duhur ligjor dhe deri më sot nuk janë dërguar asnjëra nga dëshmitë e kërkuara, ZRrE ka vendosur që aplikacioni i MC INVEST CONSULTING AD për Licencë Furnizim/Tregti të energjisë elektrike të refuzohet
6. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.
7. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.
8. Ky Vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së

Bordi i ZRrE-së:

Ali Hamiti
Kryesues

Merita Kostari
Anëtare

Theranda Beqiri
Anëtare

Naim Bejtullahu
Anëtar

Nysret Avdiu
Anëtar